



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0266

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Smartech Systems L.L.C., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Sistemi i Alarmit në AKSP me numër të prokurimit 214-24-9646-1-2-1, me 22.05.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Smartech Systems L.L.C. me nr. 2025/0266, e datës 12.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sistemi i Alarmit në AKSP me numër të prokurimit 214-24-9646-1-2-1.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e AK të AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sistemi i Alarmit në AKSP me numër të prokurimit 214-24-9646-1-2-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Smartech Systems L.L.C.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.09.2024 AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Sistemi i Alarmit në AKSP me numër të prokurimit 214-24-9646-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 Euro.

Me 26.03.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 01.04.2025, OE Smartech Systems L.L.C., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 02.04.2025.

Me 12.04.2025, OE Smartech Systems L.L.C., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0266, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Smartech Systems L.L.C., lidhur me ankesën 0266/2025:

Fillimisht shprehim shqetësimin tonë dhe kërkojmë nga OSHP si institucioni më i lartë i prokurimit publik në Kosovë të ushtrojë ndikimin e saj tek AK-të që të mos refuzojnë kërkesat për rishqyrtim pa ofruar asnjë sqarim dhe asnjë fakt.

Autoriteti Kontraktues – Sistemi i alarmit në AKSP; me nr. të prokurimit: 214-24-9646-1-2-1; me rastin e eliminimit tonë ka bërë shkeljet e lartpërmendura.

Pretendimet tona për shkeljet e lartpërmendura gjatë vlerësimit janë:

AK-AKSP me datën 26.03.2024 përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si pjesë e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues na ka njoftuar se jemi eliminuar për arsye: “GST Sh.p.k & Smartech Systems L.L.C – është i papërgjegjshëm pasi që i mungojnë: zgjatja e validitetit të ofertës për 60 ditë. Kërkesa e autoritetit kontraktues për herën e parë ka qenë me datë 27.12.2024 të zgjatet afati i ofertës deri më 03.01.2025, ndërsa O.E. e ka dërguar me 05.01.2025 në kundërshtim me kërkesën e AK-së pas afatit.

Ne nuk pajtohemi me këtë vendim pasi që e konsiderojmë të pabazuar për arsye:

AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me nr. 2024/1138 që bazuar në LPP është obligativ të respektohet nga AK.

Sa i përket pretendimit të eliminimit tonë, shkelja ka ndodhur nga vetë AK pasi që ka kërkuar zgjatjen e afatit të validitetit të ofertës me më shumë se 2 javë vonesë. Pra, nga data 11.12.2024 deri më datën 27.12.2024, nuk ka kërkuar zgjatjen e afatit, ndërsa kërkesa me datën 27.12.2024 ka qenë ditë e premte dhe në fundvit, ku një pjesë e madhe e stafit kanë qenë në pushim dhe menjëherë pas fillimit të punës më 05.01.2025 kemi dërguar zgjatjen e validitetit të ofertës. Dhe pikërisht në atë kohë kemi pasur ankesë në OSHP dhe është më se e kuptueshme që kemi qëndruar pas ofertës sonë përderisa kemi depozituar ankesë në OSHP për eliminimin tonë të

padrejtë që është vërtetuar edhe nga OSHP. Andaj për lëshimet e AK-së, konsiderojmë që nuk mund të penalizohemi ne si operatorë ekonomikë. Mos kërkesa në kohë për zgjatje të afatit është shkelje e rëndë nga ZPP bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik dhe jo shkelje nga OE për t'u eliminuar.

Si dhe anulimi i procedurës për mungesë të buxhetit pas vendimit të OSHP-së që vërteton që oferta jonë është e përgjegjshme, konsiderojmë që është shkelje e çdo parimi në prokurim publik, kjo pasi që një anulim i tillë nuk ka asnjë bazë ligjore (ju lutem të cekni se në cilin nen të ligjit jeni bazuar kur keni marrë një vendim të tillë), për më tepër projekti ka pasur kohëzgjatje 3 muaj dhe hapja e ofertave është bërë me datën 11.10.2024, e që në çdo rast do të kalonte në vitin 2025. Andaj ju duhet të siguronit buxhet për këtë projekt pasi që edhe kontrata është me poentim të çmimit dhe një anulim i tillë është diskriminues për ne duke pasur parasysh që na keni shkaktuar dëme materiale duke përfshirë edhe kostot për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, të cilën e kemi fituar, që vërteton që na keni eliminuar pa të drejtë.

Shkelja e Nenit 1.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në Nenin 1 Qëllimi, paragrafi 1: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.” Dhe paragrafi 3 “Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sillen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.”

Shkelje e të gjitha Parimeve të LPP-së.

Shkelja e Nenit 6 dhe Nenit 7

Neni 7 paragrafi 1: “Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë pasi që jemi eliminuar për lëshim të AK-së dhe nuk ka qenë e paraqitur tek kërkesat e D.T dhe Njoftimit për kontratë dhe asnjë njoftim lidhur me buxhetin dhe rrezikun e anulimit.

Shkelja e Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Në veçanti e paragrafit 4 “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ...”

Ne jemi eliminuar për arsye të lëshimit të vet AK-së.

Shkelja e Nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Paragrafi 1 “Autoriteti kontraktues do t’ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;” duke pasur parasysh që ky ishte kriteri i dhënies në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar pasi që ne jemi eliminuar edhe pse kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara më lartë, konsiderojmë se AK – AKSP, vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore, si dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së me nr. 2024/1138.

Shkelja e Neni 30 Validiteti i Tenderit – Rregullorja e Prokurimit Publik

Neni 30 Validiteti i Tenderit parasheh që nëse OE nuk e vazhdon validitetin, të eliminohet, por nuk përcakton afat se sa ditë do t’i jepen në dispozicion dhe përderisa kemi dorëzuar vazhdimin e validitetit të ofertës, nuk ka asnjë bazë ligjore eliminimi jonë. Afati i përcaktuar nga AK jashtëligjshëm ka qenë 03.01.2025 (ditë e premte si dhe ditë pune pas dy ditëve pushim zyrtar), ndërsa ne kemi dërguar konfirmimin me datën 05.01.2025 (ditë e diel), pra edhe pse afati ka qenë vetëm 3 ditë pune, ne kemi dërguar konfirmimin para ditës së 4-të të punës.

Shkelja e Nenit 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

LPP në nenin 62 nuk e parasheh anulimin e procedurës pas hapjes së ofertave me arsye të ofruara nga AK për mungesë të buxhetit, kur sic kemi sqaruar fillimisht ka pasur buxhet për ofertuesin që ka pasur çmimin më të lartë se ne, ndërsa për ne me çmim më të ulët nuk ka asnjë kuptim që të mos ketë buxhet.

Shkelja e Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Nuk është respektuar LPP me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim duke mos ofruar fakte dhe dëshmi mbi refuzimin.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara më lartë, konsiderojmë se AK – AKSP, vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Ne mbështetje te nenit 108/A te Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 AK i AKSP-së ka shqyrtuar kërkesën për ri-shqyrtim të O.E., „GST” Sh.p.k. & „Smartech Systems” L.L.C. pjesëmarrës në tenderin me titull „Sistemi i alarmit në AKSP” dhe numrit të prokurimit 214/24/26/121 & 214/24/9646/121. Vendim Mbi kërkesën për ri-shqyrtim te O.E. „GST” Sh.p.k. & „Smartech Systems” L.L.C. të datës 01.04.2025 si të pa bazuar I.REFUZOHEM si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE „GST” Sh.p.k. & „Smartech Systems” L.L.C. për aktivitetin e prokurimit me titull „Sistemi i alarmit në AKSP” me numër të prokurimit 214/24/26/121 & 214/24/9646/121.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0266, ndërsa me datë 24.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0266, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OESmartech Systems L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0266, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, duke ngritur disa pretendime ankimore të cilat janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: “Pretendimet tona për shkeljet e lartcekura gjatë vlerësimit janë: -AK-AKSP me datën 26.03.2024 përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si pjese e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues na ka njoftuar se jemi eliminuar për arsye: “GST Sh.p.k & Smartech Systems L.L.C – është i papërgjegjshëm pasi që i mungojnë: zgjatja e validitetit të ofertës për 60 ditë. Kërkesa e autoritetit kontraktues për herën e parë ka qenë me datë 27.12.2024 të zgjatet afati i ofertës deri me 03.01.2025 ndërsa O.E. e ka dërguar me 05.01.2025 në kundërshtim me kërkesën e AK-së mbas afati. Ne nuk pajtohemi me këtë vendim pasi që konsiderojmë që është i pabazë për arsye: - AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me nr.2024/1138 që bazuar në LPP është obligativ të respektohet nga AK.”

Eksperti shqyrtues sqaron që më datën 27/12/2024 AK-AKSP përmes sistemit e-prokurimi ka bërë kërkesë për zgjatjen e validitetit të ofertave për 60 ditë dhe ka kërkuar nga operatorët ekonomik që konfirmimet për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertave të dorëzohen më së largu deri më datën 03/01/2025 në ora 16:00. OE ankues kësaj kërkesë të autoritetit i është përgjigjur jashtë afatit të përcaktuar, përkatësisht konfirmimi për zgjatje të validitetit është dorëzuar me datë 05/01/2025 në orën 20:42 sipas sistemit e-prokurimi. Arsyeimi se konfirmimi është bërë

menjëherë në ditën e parë të punës për shkak të festave-pushimeve të fundvitit dhe se përderisa ka pasur ankesë në OSHP ka qenë e ditur se oferta vazhdon të jetë valide sipas ekspertit nuk qëndron për arsye se nga data 27 dhjetor kur është paraqitur kërkesa nga autoriteti e deri më datën 3 janar, OE ankues ka pasur në dispozicion 7 ditë të plota kalendarike apo 3 ditë të plota pune në të cilat është dashur të dërgohet konfirmimi dhe nuk ka vepruar sipas kërkesës së AK-së, duke dorëzuar vazhdimin e validitetit jashtë afatit të paraparë.

Nga ana tjetër sa i përket afateve të kërkesës për zgjatje të validitetit sipas nenit 30 të Rregullores së Prokurimit Publik, përkatësisht pika 30.4 sqaron që në rastin kur procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve atëherë AK duhet të kërkoj me shkrim nga operatorët pjesëmarrës të bëjnë zgjatjen e këtij validiteti para datës së skadimit. Andaj, në rastin konkret sa i përket kërkesës së AK-së e cila është bërë përafërsisht dy javë me vonesë konsiderojmë që Autoriteti nuk ka vepruar sipas pikës 30.4 të RRPP-së. Nga sqarimet e bëra vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 2

“Anulimi i procedurës për mungese të buxhetit pas vendimit të OSHP-së që vërteton që oferta jonë është e përgjegjshme konsiderojmë që është shkelje e çdo parimi në prokurim publik, kjo pasi që një anulim i tillë nuk ka asnjë bazë ligjore (ju lutem të cekni se në cilin nen të ligjit jeni bazuar kur keni marr një vendim të tillë), për më tepër projekti ka pasur kohëzgjatje 3 muaj dhe hapja e ofertave është bërë me datën 11.10.2024 e që në çdo rast do të kalonte në vitin 2025. Andaj ju duhet të siguronit buxhet për këtë projekt pasi që edhe kontrata është me poentim të çmimit dhe një anulim i tillë është diskriminues për neve duke pasqyruar që na keni shkaktuar dëme materiale duke përfshirë edhe kostot për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës të cilën e kemi fituar që vërteton që na keni eliminuar pa të drejtë.”

Me datën 26/03/2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së përmes të cilit anulohet ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin që sipas vendimit të OSHP-së 2024/1138 lënda është rivlerësuar dhe pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore nga Divizioni për Buxhet dhe Financa në mungesë financiare jemi të detyruar t'a anulojmë pasi që ky projekt ka qenë i planifikuar për vitin 2024 dhe në planin e vitit 2025 nuk figuron.

Eksperti shqyrtues sqaron që njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është bërë në muajin shtator të vitit të kaluar, ndërsa ofertat janë pranuar deri në gjysmën e muajit tetor të po atij viti, muaj të cilët janë pothuajse në fund të vitit. Nëse e marrim parasysh Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshëmrisë së Fondeve shihet se për këtë aktivitet janë ndarë fondet e nevojshme për realizimin e tij, veç të tjerash parashtrimi i ankesave në OSHP nga ana e OE ankues është bërë një muaj pas hapjes së ofertave ndërsa vendimi për këtë ankesë nuk është lëshuar deri në muajin e dytë të vitit pasues, gjë që ka lënë të nënkuptohet për AK-në që ky aktivitet është vështirë të realizohet në vitin paraprak duke krijuar mundësi që të njëjtit të planifikojnë bartjen e mjeteve buxhetore për vazhdimin e këtij aktiviteti që besojmë që ka rrjedhur si pasojë e nevojës së AK-së apo njësisë kërkuese për inicimin e tij. Pra, sipas mendimit të ekspertit shqyrtues AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurimin Publik duke anuluar aktivitetin e prokurimit për arsye të tjera të cilat nuk parashihen me këto nene. AK ka qenë e obliguar që të planifikoj kohëzgjatjen e këtij aktiviteti dhe të marrë për bazë afatet ligjore për vlerësimin e ofertave nga komisioni vlerësues dhe parashtrimin e ankesave për palët e pakënaqura me vendimet e saj dhe të parashihet mjetet e nevojshme për vazhdimin e kësaj procedure, përderisa ekziston deklarata për

disponueshmërinë e mjeteve, gjithashtu në këtë deklaratë sqarohet se ky aktivitet nuk ka qenë i planifikuar as për vitin 2024 mirëpo me rekomandimin e marrë nga Auditori i Brendshëm është dashur të zhvillohet ky aktivitet, atëherë në këtë pikë nuk shihet asnjë arsye për anulim të këtij aktiviteti, ku i njëjti nuk ka qenë i planifikuar as për vitin 2024 mirëpo prapëseprap është iniciuar si aktivitet. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i bazuar.

Po ashtu, sqarojmë që AK nuk ka vepruar sipas nenit 108/A të LPP-së duke mos kthyer përgjigje në pretendimet e ngritura nga OE ankues në kërkesën për rishqyrtim. Në këtë vendim AK vetëm ka refuzuar këtë kërkesë pa e arsyetuar fare mos qëndrimin e saj.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur në tërësi besimin ekspertit shqyrtues sa i përket përgjigjeve në këto pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Po ashtu, duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Sistemi i Alarmit në AKSP me numër të prokurimit 214-24-9646-1-2-1 dhe PSH vendos që të lë në fuqi anulimin e kësaj procedure.

Në rastin konkret PSH e mbështet ekspertin shqyrtues lidhur me konstatimin sa i përket kërkesës së AK-së e cila është bërë përafërsisht dy javë me vonesë konsiderojmë që Autoriteti nuk ka vepruar sipas pikës 30.4 të RRPP-së. Dhe sipas Rregullores nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, nenit 97, konsiderohet shkelje e rëndë nga ana e Zyrtarit përgjegjës të prokurimit për të cilën palët duhet ta njoftojnë edhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Andaj pretendimi kualifikohet si pjesërisht i bazuar. Por që është evidente dhe i qëndrueshëm fakti se ankuesi sipas konstatimit të ekspertit shqyrtues nuk ka vepruar sipas kërkesës së AK.

Paneli Shqyrtues në këtë rast i shqipton vërejtje Zyrtarit përgjegjës të prokurimit se nëse në të ardhmen vërehen konstatime të tilla të ngjashme do të veprojnë konform nenit 25 par. 8 dhe 9 të LPP, me kërkesë në KRPP për revokim të çertifikatës së prokurimit.

Arsyeja që Paneli Shqyrtues nuk e mbështet ekspertin shqyrtues është vetëm sa i përket rekomandimit të tij/saj që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe përgjigjes në pretendimin sa i përket nenit 62 të LPP, për shkak se Paneli Shqyrtues duke u bazuar në nenin 1, 7, 59 dhe 62, konsideron se ky aktivitet duhet të anulohet ngase këtu shumica e OE pjesëmarrës kanë të njëjtin problem sa i përket zgjatjes së validitetit të ofertave, por edhe mangësi tjera për të cilat nuk kanë paraqitur ankesë fare në OSHP dhe në mënyrë automatike kualifikohen si palë pa interes, konform nenit 4.1.26 të LPP.

Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 8 .5 nder te tjera thotë: Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar. Tek Disponueshmeria e mjeteve Neni 3: Shqyrtimi, nder te tjera shënon: Kjo “Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim te kontratave para publikimit te Njoftimit për dhënie te kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.

Në këtë rast pas shqyrtimit nga personat e autorizuar para publikimit te njoftimit për dhënie te kontratës, zyra e prokurimit ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin që sipas vendimit të OSHP-së 2024/1138 lënda është rivlerësuar dhe pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore nga Divizioni për Buxhet dhe Financa në mungesë financiare jemi të detyruar t’a anulojmë pasi që ky projekt ka qenë i planifikuar për vitin 2024 dhe në planin e vitit 2025 nuk figuron. Nëse i referohemi LPP-së Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kështu që, si pasojë e gjendjes së krijuar, përgjegjësin e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave, ndërsa, PSh detyrimisht duhet ta lë në fuqi anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik si dhe rregulloret financiare. Si rrjedhojë, AK nuk mund të vihet në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion. Andaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në këtë informacion të detajuar dhe duke u bazuar edhe në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues u bind se ky aktivitet të prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim, ngase vetë AK këtë aktivitet të prokurimit e ka iniciuar në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, pa qenë i planifikuar fare as për vitin 2024. Por edhe duke u bazuar në interpretimin e KRPP nr. 7 të publikuar më 22.11.2022.

Andaj Paneli e konsideroj të arsyeshme që me rastin e vendosjes meritore në këtë çështje juridike-administrative, tua njeh të drejtën e kthimit të tarifës ankimore. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, dhe të prolongimi deri në pafundësi të aktivitetit të prokurimit, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**
- **OE - Smartech Systems L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: